



DORACAK PËR SHKOLLA

EC
MA NORYSHE

SHËNIM:

Ky doracak është zhvilluar në kuadër të Projektit: Eko Shkolla, përkrahur nga: 'Programi i Shoqërisë Civile për Shqipërinë dhe Kosovën', financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) në partneritet me Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (PA).

Kushtrim Shaipe

Autor

PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA.....	1
TABELA E FIGURAVE	2
QËLLIMI I DORACAKUT DHE PËRDORSHMËRIA.....	3
MBULUESHMËRIA/TEMAT	3
Ajri.....	3
Uji.....	4
Toka.....	4
Mbeturinat.....	4
Energjia	5
HARMONIZIMI ME KURRIKULËN DHE PROCESIN E EDUKIMIT.....	5
MASAT E REKOMANDUARA DHE PRAKTIKAT E MIRA	7
Ajri.....	7
Shembull i Praktikave të Mira për Masa të Ajrit.....	9
Uji.....	10
Shembull i Praktikave të Mira për Masa të Ujit	12
Toka.....	12
Shembull i Praktikave të Mira për Masa të Tokës.....	15
Mbeturinat.....	16
Shembull i Praktikave të Mira për Masa të Mbeturinave.....	18
Energjia	19
Shembull i Praktikave të Mira për Masa të Energjisë	21
ROLI I KOMUNITETIT	22
Përfshirja e Këshillit të Shkollës	22
Përfshirja e Komunitetit të Gjerë.....	23
Avokimi për Nisma që Tejkalojnë Kompetencat e Shkollës.....	23

TABELA E FIGURAVE

Figura 1. Masat e Parapara për Nën-Temën: Ajri	8
Figura 2. Shembull i Zbërthyer: Ajri	9
Figura 3. Masat e Parapara për Nën-Temën: Uji	11
Figura 4. Shembull i Zbërthyer: Uji	12
Figura 5. Masat e Parapara për Nën-Temën: Toka	14
Figura 6 Shembull i Zbërthyer: Toka	15
Figura 7. Masat e Parapara për Nën-Temën: Mbeturinat	18
Figura 8. Shembull i Zbërthyer: Mbeturinat	18
Figura 9. Masat e Parapara për Nën-Temën: Energjia	20
Figura 10. Shembull i Zbërthyer: Energjia	21

DORACAK PËR NJË EKO SHKOLLË

QËLLIMI I DORACAKUT DHE PËRDORSHMËRIA

Qëllimi i përgjithshëm i projektit, “EKO SHKOLLA”, përmes të cilit është zhvilluar ky Doracak, është të avokojë për konceptin e shkollës ekologjike në Komunën e Prizrenit përmes pilotimit të modelit dhe metodologjisë përkatëse të mbrojtjes së mjedisit me pjesëmarrjen e gjerë të nxënësve dhe mësuesve në një shkollë të përzgjedhur në mënyrë konkurruese. Koncepti i edukimit mjedisor është i ri për shkollat e Kosovës dhe stafin mësimdhënës, andaj edhe si rezultat ka mungesë të programeve gjithëpërfshirëse dhe praktike që synojnë sensibilizimin mjedisor dhe aktivizmin në këto tema. Në shkolla kryeson teoria para praktikës, me mundësi të pakëta (apo inekzistente në disa raste) për t'u angazhuar në aktivitete sociale dhe komunitare. Përvojat botërore tregojnë se shkolla ekologjike është një fenomen në rritje, i cili inkurajon të rinjtë të angazhohen në mjedisin e tyre duke u dhënë atyre mundësinë për ta mbrojtur atë në mënyrë aktive. **Fillon në klasë, zgjerohet në shkollë, që përfundimisht të nxisë ndryshimin në komunitetin e gjerë.** Eko Shkolla është një metodologji e dëshmuar, pasi ndër të tjera përfshin të gjithë, përmirëson mjediset shkollore, motivon të rinjtë dhe përfshin komunitetet. Doracaku detajon procesin e shëndrrimit në shkollë ekologjike. Dokumenti përfshin këshilla për politikatat se si të zhvillohet, formalizohet dhe zgjerohet më tej modeli dhe metodologjia e shkollës "eko" në shkollat e tjera publike të Prizrenit.


[Plani Strategjik për Arsimin në Kosovë 2017 – 2021](#) ofron një kornizë afirmative dhe udhërrëfyese për planifikimin e edukimit dhe arsimit në nivel vendor. Ky plan mundëson planifikim më të mirë të masave konkrete në mënyrë që të sigurohet sinergji në mes të nismave në nivele të ndryshme të organizimit të qeverisjes në vend. Funkcionimi i menaxhimit të shkollës rregullohet me [Ligjin për Arsimin Parauniversitar të Kosovës, nr. 03/L-032](#), 2011 dhe me [Udhëzimin Administrativ i MASHT NR. 08.2014 për Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe të Zëvendës Drejtorit të Institucionit Edukativo-Arsimor dhe Aftësues](#). Nëse i referohemi Ligjit për arsimin parauniversitar të Republikës së Kosovës, ekzistimi i organeve udhëheqëse dhe themelimi i tyre ka për qëllim lehtësimin e funksionimit sa më efikas të menaxhimit të shkollës. Sipas këtij ligji, përgjegjësia kryesore për menaxhimin e shkollës bie mbi drejtor-in/en me obligime të shumta. Në mënyrë që puna në një institucion shkollor të shkojë mbarë dhe të realizohen objektivat e caktuara të parapara me planin zhvillimor të shkollës, Drejtori bashkëpunon me [Këshillin Drejtues të Shkollës](#), me Këshillin e Prindërve, me Këshillin e Nxënësve, me Këshillin e Arsimtarëve, si dhe me Këshillin e Klasave dhe Aktiveve Profesionale. Duke qenë se shëndrrimi në eko shkollë kërkon përfshirjen nga të gjithë, rekomandohet që të gjitha organet drejtuese të shkollës, të jenë të përfshira sipas rolit të tyre respektiv.

Ky Doracak më së miri mund të funksionalizohet si pjesë e hartimit të Planit Zhvillimor të Shkollës (PZSH) që duhet të realizohet nga secila shkollë sipas modelit të zhvilluar nga [MASHT](#). Fusha e dytë që ky plan mbulon është titulluar Kultura dhe Mjedisi Shkollor. Duke e integruar në dokumente tashmë të miratuara për të gjitha shkollat, mundësojmë edhe korrigjimin e vazhdueshëm të praktikave negative.

MBULUESHMËRIA/TEMAT

Ky Doracak mbulon pesë temat kryesore për t'u konsideruar nga shkollat në kuadër të masave transformuese në një Eko Shkollë. Këto tema përfshijnë Ajrin, Ujin, Tokën, Mbeturinën, dhe Energjinë; si dhe masat e sygjera për tu ndërmarrë në adoptimin e parimeve të përgjithshme të EKO shkollës.

Ajri



Kjo temë ngërthen në vete masat kryesore që mund të ndërmerren nga drejtorët e shkollave për përmirësimin e cilësisë së ajrit. Marrë parasysh ndërlidhshmërinë e temave, masat për ajrin parashohin edhe masa në fushën e transportit, ngrohjes dhe energjisë. Gjithashtu, masat për përmirësimin e cilësisë së ajrit mund të përfshijnë tema të ndërlidhura me token dhe ujin (p.sh.

DORACAK PËR NJË EKO SHKOLLË

gjelbërimi i sipërfaqeve). Marrë në konsideratë shtrirjen e temës së ajrit përtej kufijëve të ngushtë të shkollës, masat efektive për përmirësimin e cilësisë së ajrit, nënkuptojnë bashkërendim të ngushtë me akterët komunalë (drejtoritë dhe komuna) dhe kombëtar (MASHT, MMPH, Agjencitë e Pavarura, Qeveria, Kuvendi), për të siguruar rezultate të mirëfillta dhe afatgjata. Përdorimi i ajrit si burim i energjisë gjithashtu parashihet si masë e ndërlidhur me disa tema.

Uji



Kjo temë gjithashtu ngërthen në vete masa ndër-sektoriale dhe përtej temës së ngushtë të ujit si burim esencial. Tregon për praktika të mira të ruajtjes/konservimit të ujit në natyrë me efekte të githëmbarshme pozitive për ambientin dhe natyrën. Kjo temë gjithashtu përmban masat e rekomanduara për reflektim në mënyrën e përdorimit të ujit, masave për parandalimin e ndotjes së ujërave nëntokësore dhe mbitokësore, si dhe promovimin e një kulture të gjithëmbarshme të kujdesit dhe vetëdijes së lartë të popullsisë për rëndësinë e ujit. Masat në ruajtjen e higjienës publike duke minimizuar ndotjen nga materiet e rrezikshme kimike të materialeve dezinfektuese gjithashtu janë të përfshira brenda temës së Ujit. Ndarja e sistemeve të kanalizimit nga ato të ujërave sipërfaqësore është masë tjetër në kuadër të temës së ujit. Andaj edhe tema e ujit përmban elemente që kërkojnë harmonizim me akterë të nivelit komunal, rajonal (kompanitë rajonale të ujësjellës-kanalizimit) dhe qendror.

Toka



Brenda kësaj teme përfshihen masat për shfrytëzimin dhe përmirësimin e tokës, hartëzimin e hapësirave të gjelbërta, revitalizimin e hapësirave të dëmtuara / ndotura ekologjiksht, si dhe ndërtimin e një kulture kolektive në bashkësi për ruajtjen dhe përmirësimin e hapësirave të përbashkëta. Brenda kësaj teme përfshijnë edhe masa që preken nga temat e tjera si uji, ajri (p.sh. mbjellja e drunjëve ndihmon parandalimin e erozionit të tokës në vendet ku ekziston një rrezik i tillë, por edhe në ruajtjen e burimeve nëntokësore të ujit, dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit. Gjithashtu, krijimi i Eko-Grupeve të nxënësve që do të përfshihen drejtëpërdrejtë edhe në masat e temave të tjera si fushata, aksione, etj. Gjithashtu, masat e parapara në temën e tokës ndërlidhen edhe me mbeturinat dhe energjinë.

Mbeturinat



Kjo temë mbulon masa që çojnë në menaxhimin e qëndrueshëm të mbeturinave dhe masa të ndarjes, reciklimit, dhe ri-përdorimit. Përkundër modernizimit të një pjese të infrastrukturës menaxhuese, me përkrahje të Qeverisë Japoneze, Komuna e Prizrenit ka ende shumë punë për tu bërë deri në zhvillimin e një sistemi të qëndrueshëm të grumbullimit të mbeturinave. Një pjese të mirë të popullsisë dhe territorit, ngjashëm me pjesët e tjera të Kosovës, nuk i ofrohet shërbimi i grumbullimit të mbeturinave nga kompanitë rajonale përgjegjëse. Në mungesë të mekanizmave dhe shërbimeve publike të grumbullimit të ndarë të mbeturinave, duhet të ndërlidhen zinxhirët jo-formal dhe komercialë të reciklimit (grumbulluesit individual, pikat grumbulluese, etj.). Ndërtimi i një vetëdije shoqërore rreth zvogëlimit të sasisë së mbeturinave të prodhuara përmes ri-përdorimit, ndarjes, dhe reciklimit të materialeve është esenciale për zvogëlimin e efekteve negative në ambient dhe shëndet. Gjithashtu, masat efektive përfshijnë trajtimin e mbetjeve (p.sh. incinerim/djegje, për të përmbushur nevojat e ngrohjes, ujit të ngrohtë, apo energjisë).

DORACAK PËR NJË EKO SHKOLLË

Energjia



Auditimi i burimeve të energjisë, shfrytëzimi racional, si dhe zbërthimi i masave që kursejnë energjinë të gjitha parashihen brenda temës së energjisë në funksion të zvogëlimit të ndotjes dhe kostos. Shfrytëzimi i energjisë gjithashtu përbëhet nga dy dimensione atij të shfrytëzimit të burimeve të ri-përtrishme të energjisë (diellit, erës), si dhe masave të efikasitetit të energjisë si izolimet, ndriçime automatike, pajisje me efikasitet të lartë, izolimet e ndërtesave etj. Edhe brenda kësaj teme disa prej masave ndërlidhen me institucione në nivel komunal dhe kombëtar.

HARMONIZIMI ME KURRIKULËN DHE PROCESIN E EDUKIMIT

Që nga viti 2016, MASHT ka aplikuar [Kurrikulën e re Bërthamë](#) për Shkollat Fillore¹ dhe ato të Mesme të Ulëta², mirëpo mungesa e kapaciteteve dhe njohurive të mësimdhënësve për zbatimin e këtij programi, ka pamundësuar zbatimin efektiv të tij në praktikë. Kjo kurrikulë ofron bazën e nevojshme për të plotësuar aspektin e parë të EKO shkollës (klasa). [Paketa e Gjelbër](#), e zhvilluar nga Qendra Rajonale për Mjedis (REC) dhe përkrahur nga [MASHT](#), bën zbërthimin e kësaj kurrikule në praktikë, në të gjitha lëndët relevante. Marrë parasysh që kjo përmbledhje instrumentesh është aprovuar nga MASHT, si dhe materialet për aplikimin e tyre janë shpërndarë nëpër shkolla të Kosovës, edhe paraqet mundësinë më të mirë për arritje të uniformitetit në të gjitha shkollat. Ky Doracak, synon të mbulojë aspektin e dytë (më në gjerësi), dhe aspektin e tretë (më pak) për të kompletuar të gjitha nivelet e intervenimit për krijimin e një Eko Shkolle që krijon ndikim pozitiv për ambientin dhe shoqërinë.

Koncepti i [Zhvillimit të Qëndrueshëm](#) është bërë term i mirënjohur me shtrirje të gjerë në legjislacion, praktika/politika publike dhe private, dhe sjellje individuale në shoqëri. Ai tashmë është prezent në të gjitha nivelet, disiplinat/fushat dhe diskutet. [BE](#) ka bërë aspektin ambiental, pjesë të obligueshme përbërëse të të gjitha ligjeve, ndërsa [politikat për mbrojtjen e ambientit](#) dhe ndryshimeve klimatike të prioritetit më të lartë. Zbatimi dhe arritja e [Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm \(OZHQ\)](#) në menaxhimin e burimeve mjedisore është vështirë i realizueshëm pa përfshirjen e tyre në programet mësimore. Zhvillimit të Qëndrueshëm ju dha ky emër në [raportin e vitit 1987](#) nga Komisioni Botëror i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin dhe Zhvillimin, nën udhëheqjen e ish-kryeministres Norvegjeze, [Gro Harlem Brundtland](#), ku ai definohet si "zhvillimi që plotëson nevojat e tashme pa kompromentuar aftësinë e brezave të ardhshëm për të përmbushur nevojat e tyre". Botërisht, sfidat ambientale dhe të ndryshimeve klimatike me të cilat ballafaqohet njerëzimi dhe efektet e së cilave janë të dukshme në mbarë botën, mund të adresohen efektivisht vetëm përmes përfshirjes së zhvillimit të qëndrueshëm në sistemet e arsimit publik në të gjitha fushat.

Në mbarë botën, roli i mësimdhënësve qysh prej nivelit parashkollor, konsiderohet të jetë thelbësor në përshtetimin e ndryshimeve kulturore dhe sociale, si dhe në adaptimin lokal të konceptit të Zhvillimit të qëndrueshëm. Arsimit për Zhvillimin e Qëndrueshëm (AZHQ) trason udhën drejt një vizioni ku secili do të edukohet mbi vlerat, sjelljen, dhe stilin e jetesës të nevojshëm për një të ardhme të qëndrueshme dhe për një transformim social pozitiv. AZHQ nënkupton një transformim themelor të të reflektuarit dhe vepruarit. AZHQ në vete paraqet proces të të menduarit dhe mësuarit që gjatë vendim-marrjes konsideron të ardhmen afatgjatë të ekonomisë, mjedisit, si dhe zhvillimin e barabartë të të gjitha grupeve dhe komuniteteve në shoqëri. AZHQ duhet të kuptohet si një pjesë themelore e edukimit cilësor, thelbësor në nocionin e të mësuarit gjatë gjithë jetës: Të gjitha institucionet arsimore duhet ta konsiderojnë si përgjegjësi angazhimin intenziv rreth çështjeve të zhvillimit të qëndrueshëm.

¹ MASHT. Kurrikula Berthame per klaset I – V. Gusht 2016. <https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/03/kurrikula-berthame-1-finale-2.pdf>

²MASHT. Kurrikula Berthame per klaset VI – IX. Gusht 2016. <https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/03/korniza-berthame-2-final.pdf>

DORACAK PËR NJË EKO SHKOLLË

Reforma e kurrikulës konsiderohet si faktor kyç për zhvillimin të qëndrueshëm që i shërben të tashmes dhe së ardhmes njëkohësisht. Deri më tani, fokus i reformave ka qenë në ndërtimin e kompetencave kyçe, gjithëpërfshirjes, përmirësimit të sistemeve të testimit dhe vlerësimit, metoda të reja të mësimdhënies etj. Këto aspekte janë në përputhje me kërkesat e kohës, ku sistemet arsimore në mbarë botën po transformohen në hap me zhvillimet e shpejta ekonomike, sociale, shkencore, të prirë nga teknologjia dhe avancimet në këtë fushë.

MASHT me sukses ka finalizuar Kornizën Kurrikule të Arsimit Para-Universitar dhe Kurrikulat Bërthamë për të gjitha nivelet para-universitare. Aktualisht KKK është duke u zbatuar në të gjitha shkollat e arsimit fillor (shkollat fillore të përfshira në pilotim, klasat 1, 2, 6, e 7) ndërsa klasat 2 dhe 7 në të gjitha shkollat. [Qendra Rajonale e Mjedisit](#) në bashkëpunim me Zyrën e Kurrikulës në MASHT kanë integruar parimet e Arsimit të Zhvillimit të Qëndrueshëm në Kornizën e Kurrikulës së Kosovës dhe dy kurrikulave bërthamë. Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm, në mënyrë të veçantë është përfshirë në kuadër të trajtimit të udhëzimeve metodologjike, përkatësisht trajtimit të çështjeve ndëkurrikulare. Trajtimi i kësaj pjese pritet të zërthehet. AZHQ është i integruar në KKK, si vijon:

- **Qëllimet në arsimin parauniversitar.** Nxënësit do të përkrahen që të zhvillojnë përgjegjësinë për veten dhe për të tjerët, për pasojat e veprimeve personale, si dhe në vetëdijësimin për rëndësinë dhe përgjegjësinë për ndërmarrjen e iniciativave. Ata gjithashtu do të përkrahen të zhvillojnë përgjegjësinë për mjedisin në kontekst të vetëdijësimit për arsim për zhvillim të qëndrueshëm.
- **Kompetenca kryesore,** në mënyrë të veçantë, Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm.
- **Parimet e kornizës së kurrikulës dhe të sistemit të arsimit parauniversitar** – në mënyrë të veçantë te parimi Mësimdhënia dhe të nxënësve të integruar dhe koherent: Perspektivën e të nxënësve gjatë gjithë jetës: Kurrikula do t'u mundësojë nxënësve të përgatiten që të ballafaqohen me sukses në jetën e tyre të përditshme me sfidat e vazhdueshme dhe me mundësitë që ofron një shoqëri e dijes dhe e të nxënësve, duke u kushtuar vëmendje të veçantë: mësimi për të nxënë, zotësisë për vlerësimin dhe procedimin efektiv e të ndërgjegjshëm të informacionit, të nxënësve elektronik dhe aftësisë për shfrytëzimin e teknologjive të epokës digjitale (si: teknologjia e komunikimit dhe e informimit, të nxënësve elektronik, si mënyrë e të menduarit dhe e të vepruarit, vetëdijësimi për mediet, shkathtësitë proaktive jetësore, arsimin për zhvillim të qëndrueshëm).
- **Përshkrimi i fushave të kurrikulës** - secila fushë e kurrikulës, në thellësi të përshkrimit ka elemente të arsimit për zhvillim të qëndrueshëm.
- **Fjalori i KKK/ Arsimit për Zhvillim të Qëndrueshëm:** Procesi i zhvillimit të njohurive të nxënësve, i të kuptuarit, i shkathtësive dhetributeve të nevojshme për të punuar dhe jetuar në një mënyrë që mbron mirëqenien mjedisore, sociale dhe ekonomike, si në të tashmen ashtu edhe për brezat e ardhshëm.
- **Një nga sfidat me të cilat ballafaqohet shoqëria kosovare: Zhvillimi i Qëndrueshëm:** Në një botë gjithnjë e më të globalizuar, ku cilësia e jetës në tokë, për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm, është e kërcënuar, nxënësit duhet të pajisen me dije, me shkathtësi dhe me qëndrime për t'u kujdesur me përgjegjësi për mjedisin e krijuar nga natyra dhe nga dora e njeriut, në mënyrë që t'u shmangen shpërdorimit të burimeve dhe praktikave të tjera të papërgjegjshme. Kjo kërkon që të rinjtë të vetëdijësohen jo vetëm për parimet dhe përvojat e kohezionit shoqëror dhe gjithëpërfshirës, por edhe se si të luftohen varfëria, marginalizimi, diskriminimi dhe padrejtësia në mënyrë sa më efektive.

DORACAK PËR NJË EKO SHKOLLË

MASAT E REKOMANDUARA DHE PRAKTIKAT E MIRA

Kjo pjesë e Doracakut fokusohet në masat specifike në secilën prej temave të mbuluara. Shpesh masat e propozuara kanë ndikim shumë-dimensional duke ndikuar kështu në përmirësimin e disa aspekteve njëkohësisht.

Ajri



Ajri është elementi bazik dhe kushti i parë për jetë. Aktiviteti njerëzor, sidomos në dhe rreth qendrave më të mëdha urbane, cilësohet si faktori kryesor për prishjen e cilësisë së ajrit. Në pjesën më të madhe të Kosovës, përfshirë Prizrenin, cilësia e ajrit në disa zona është jo e kënaqshme, ndërsa në periudha të caktuara të vitit (p.sh. dimrit) kalon nivele të rrezikshme për shëndetin. Ndotësit më të mëdhenjë të ajrit janë trafiku (sidomos në afërsi të qendrave urbane dhe zonave industriale/biznesore) dhe burimet e energjisë dhe ngrohjes. Mungesa e aktivitetit të theksuar industrial në kontekstin e ajrit është aspekt pozitiv, pasi të njëjtat nuk evidentohen si ndotës. Automjetet, sidomos ato më të vjetrat që nuk plotësojnë standardet bashkëkohore ambientale, llogariten të jenë

shkaktarët kryesorë të ndotjes së ajrit në nivel lokal. Ngrohja me lëndë djegëse me ndotje të lartë dhe efikasitet të ultë (thëngjill, naftë) është shkaktari i dytë më i lartë i ndotjes së ajrit në nivel lokal. Marrë parasysh që shkaktarët (dhe akterët përgjegjës për zgjidhje) shpesh janë jashtë shkollës, masat e sygjera për përmirësimin e cilësisë së ajrit në shumë raste tejkalojnë institucionin e shkollës dhe kërkojnë bashkërendim me akterë të tjerë.

Masa	Ndikimi	Palët e Përfshira	Hapat
Niveli i Shkollës			
Mbjellja e Drunjëve (sidomos përgjatë shtretërve të lumenjëve dhe në terrene më të pjerrëta). Drunjët frutorë mund të shërbejnë për nisma kompostimi dhe përmirësimi të ushqyeshmërisë së fëmijëve.	Shumë i lartë, sidomos në thithjen e ndotësve dhe grimcave të dëmshme si CO2 dhe SO2. Një dru frutor i rritur mund të absorbojë deri në 21.8 kg të CO2 në vit, dhe mund të thithë rreth 1 ton në periudhë 40 vjeçare.	Nxënësit, Këshilli i Shkollës, Komuniteti i Gjerë(Prindërit)	Hartimi i planit të mbjelljes (drunjëzimit); Miratimi i tij në këshillin e shkollës; Hartimi i planeve vjetore; Përfshirja e komunitetit; Ndërmarrja e fushatave.
Përshtatja e sistemit të ngrohjes dhe bojlerëve sipas standardeve të BE-së dhe përfshirja e teknologjive moderne për rritje të efikasitetit (smart buildings).	Shumë i lartë, sidomos në zvogëlimin e ndotjes dhe shkurtimin e kostove.	Shkolla, Komuna, MASHT	Vlerësimi/Auditimi i Sistemit të Ngrohjes; Vlerësimi i investimit; Kërkesat për investim tek institucionet relevante dhe donatorëve.
Montimi i Matësve të cilësisë së ajrit dhe inkuadrimi i tyre në sistemin online në https://www.airvisual.com apo të ngjashme	Ndikim indirekt, pasi mundëson vendimmarrje të bazuar në të dhëna. Gjithashtu, ndikon në vetëdijësim të nxënësve dhe edukim përmes teknologjisë.	Shkolla, donator potencial, komuna, platformat online.	Hartimi i Planit të veprimit për blerjen dhe instalimin e matësve; Identifikimi i burimit për financim/sponsorim; Blerja dhe instalimi; Monitorimi i ajrit dhe raportimi në kohë reale.
Niveli Komunal			
Kufizimi i qarkullimit për makina në afërsi të shkollave si dhe vendosja e barrierave për parking	Shumë i lartë, sidomos në zvogëlimin e ndotësve dhe grimcave të dëmshme si CO2 dhe SO2. Një pjesë e konsiderueshme e trafikut dhe ndotjes krijohet rreth shkollave dhe për shkak të shkollave (në	Komuna, Policia, Ministria e Infrastrukturës	Vlerësimi i mundësive të kufizimit të qarkullimit rreth objekteve shkollore; Kërkesat për veprim tek institucionet relevante; Kordinimi me komunën dhe policinë pas vendosjes së

DORACAK PËR NJË EKO SHKOLLË

	oraret kur fillon dhe mbaron mësimi). Kufizimet e pjesëshme apo të plota do të përmirësonin cilësinë e ajrit		shenjave.
Plani Komunal i drunjëzimit dhe gjelbërimit	Planifikimi dhe zbatimi i projekteve të drunjëzimit shihet si një prej masave më efikase të luftimit të ngrohjes globale dhe ndryshimeve klimatike.	Komuna, MMPH, MAPL, Agjencia e Pyjeve, Nxënësit Komuniteti,	Zhvillimi i planit të mbjelljes (drunjëzimit); Miratimi i tij në Këshillin Drejtues të shkollës; Hartimi i planeve vjetore; Përfshirja e komunitetit; Ndërmarrja e fushatave.
Projekte infrastrukturore për promovim të transportit pa vetura (shtigje biciklistash, hapësira për këmbësorë)	Shumë i lartë, sidomos në zvogëlimin e ndotësve dhe grimcave të dëmshme si CO2 dhe SO2. Promovimi i kulturës së biçikletave apo formave të tjera të pastërta të transportit (skuterë, trotinetë, biçikleta elektrike, etj).	Komuna, Policia, Ministria e Infrastrukturës?	Vlerësimi i mundësive të kufizimit të qarkullimit rreth objekteve shkollore; Kërkesat për veprim tek institucionet relevante; Koordinimi me komunën dhe policinë pas ndërtimit të infrastrukturës dhe shënjimit adekuat.
Niveli Rajonal			
Eliminimi i Deponive Ilegale	E lartë sidomos në eliminimin e erërave të pakëndshme përreth shkollave dhe vendbanimeve që vijnë nga deponi ilegale.	Komuna, Nxënësit dhe Komuniteti, OJQ-të ambientale, Kompania Rajonale e Menaxhimit të mbeturinave, inspektoratet, policia.	Vlerësimi i situatës dhe identifikimi i zonave me deponi ilegale; Kërkesat për veprim tek institucionet relevante; Koordinimi me komunën dhe policinë pas ndërtimit të infrastrukturës dhe shënjimit adekuat; Organizimi i aksioneve të pastrimit me nxënës.
Niveli Kombëtar			
Avokimi për ashpërsim të masave ndëshkimore për krimet ambientale (prerjen ilegale të drunjëve, degradimin e shtretërve të lumenjeve dhe ndotësve tjerë).	Shënimi i ditëve ndërkombëtare me klubet e shkollës dhe komunitetin e nxënësve me veprime simbolike, tërheqje vëmendjen e mediave dhe publikut dhe aktualizon ceshtjen e krimeve ekologjike.	Komuna, Nxënësit dhe Komuniteti, Agjencioni i për Mbrojtje të Ambientit, MMPH	Vetëdijësimi i Popullsisë për raportim të krimeve ambientale; Bashkëpunim me organet e rendit; Fushata me nxënës; drejtuar institucioneve.
Plani Kombëtar të Pyllëzimit	Planifikimi dhe zbatimi i projekteve të drunjëzimit është një prej masave më efikase të luftimit të ngrohjes globale dhe ndryshimeve klimatike. Roli i shkollave në angazhimin e vullnetarëve ulë koston e projekteve pyllëzuese.	Komuna, MMPH, MAPL, Agjencia e Pyjeve, Nxënësit Komuniteti,	Avokim për planin kombëtar të pyllëzimit në ditë të shënuara ndërkombëtare; Përfshirja e komunitetit Ndërmarrja e fushatave të mbjelljes.

Figura 1. Masat e Parapara për Nën-Temën: Ajri

Titulli i Projektit: Mbjellja e Drunjëve

Ndikimi i Praktikës: Shumë i lartë, sidomos në thithjen e ndotësve dhe grimcave të dëmshme si CO2 dhe SO2. [Një dru frutor](#) i rritur mund të absorbojë deri në 21.8 kg të CO2 në vit, dhe mund të thithë rreth 1 ton në periudhë 40 vjeçare. Gjithashtu drunjët frutorë mund të shërbejnë për nisma kompostimi dhe përmirësim të ushqyeshmërisë së fëmijëve. Përgjatë shtretërve të lumenjëve dhe në terrene më të pjerrëta, gjithashtu shërben për parandalimin e vërrshimeve, si dhe errozionin e tokës.

Procesi i Mundshëm: Krijohet harta e gjelbërimit të oborrit dhe hapësirave publike rreth shkollës në bashkëpunim me komunitetin, ku përcaktohen numri, lloji dhe lokacionet tentative të drunjëve në zone. Në bazë të saj, hartohet plani i veprimtimit për drunjëzim, i cili aprovohet në Këshillin e Shkollës. Plani i aprovuar, shoqërohet me buxhetin tentativ, dhe dorëzohet për financim me një kërkesë/përshkrim të shkurtër të projektit tek burimet e synuara të financimit. Zbatimi dhe mirëmbajtja mund të fillojnë si faza vetëm pasi të jetë siguruar financimi, dhe atë sipas rregullave dhe procedurave të pales financuese. Në rast të financimit vetanak, procedurat dhe procesi definohej, aprovohen dhe mbikëqyren nga Drejtori dhe Këshilli i Shkollës.

Burimi i Financimit: Varësisht prej vlerës së investimit (madhësisë së sipërfaqes për drunjëzim), financimi mund të kërkohet brenda resurseve vetanake (p.sh. donacione nga prindërit), ose (në rast se duke kërkuar përkrahje nga komuna, ministritë, donator ndërkombëtarë, apo edhe komuniteti lokal i biznesit.

Zbatim Gjithëpërfshirës: Është tejet e rëndësishme që gjatë zbatimit (pas sigurimit të financimit), procesit të jetë gjithëpërfshirës. Jashta palëve formale në proces, përfshirja e nxënësve përmes Eko Klubeve, në zbatimin e aktiviteteve në terren është jetike për ndërtimin e ndërgjegjes kolektive ambientale dhe përgjegjshmërinë qytetare ndaj ambientit.

Palët në Proces: Në proces rekomandohet të përfshihen jashta anëtarëve të Këshillit Drejtues edhe prindër/anëtarë të komunitetit me përvoja / ekspertiza me rëndësi për projektin (p.sh. agronomë, urbanistë, biznese të prodhimit të drunjëve, etj. Kjo ndikon pozitivisht edhe në ngritjen e nivelit profesional të nismave/projekteve, ashtu ndihmon edhe me rritëzimin në sektorin relevant.

Figura 2. Shembull i Zbërthyer: Ajri

DORACAK PËR NJË EKO SHKOLLË

Uji



Kjo temë gjithashtu ndërthen në vete masa ndër-sektoriale dhe përtej temës së ngushtë të ujit si burim esencial për jetë. Tregon për praktika të mira të ruajtjes/konservimit të ujit në natyrë me efekte të githëmbarshme pozitive për ambientin dhe natyrën. Kjo temë gjithashtu përmban masat e rekomanduara për reflektim në mënyrën e përdorimit të ujit, masave për parandalimin e ndotjes së ujërave nëntokësore dhe mbitokësore, si dhe promovimin e një kulture të gjithëmbarshme të kujdesit dhe vetëdijes së lartë të popullsisë për rëndësinë e ujit. Masat në ruajtjen e higjienës publike që zvogëlojnë ndotjen nga materiet e rrezikshme kimike të materialeve dezinfektuese gjithashtu janë të përfshira brenda temës së ujit. Ndarja e

sistemeve të kanalizimit nga ato të ujërave sipërfaqësore është masë tjetër në kuadër të temës së ujit. Andaj edhe tema e ujit përmban elemente që kërkojnë harmonizim me akterë të nivelit komunal, rajonal (kompanitë rajonale të ujësjellës-kanalizimit) dhe qendror. Marrë parasysh ndërlidhjen e ujërave sipërfaqësore me ato nëntokësore, si dhe nevojën e lartë për adresimin e sigurisë së ujit në tërë vendin, veprimet e sygjeruara nën masat e ujit duhet të trajtohen me prioritet të shtuar.

Masa	Ndikimi	Palët e Përfshira	Hapat
Niveli i Shkollës			
Rubinetë me sensorë në të gjitha hapësirat e shkollës.	I lartë për sa i përket shfrytëzimit racional të ujit.	Nxënësit, Këshilli i Shkollës, Komuniteti i Gjerë (Prindërit), Komuna	Vlerësimi i situatës; Kërkesat për veprim tek komuna; Koordinimi me komunën; Informimi i nxënësve dhe stafit për përdorim adekuat.
Pasqyra solare për ujë të ngrohtë për nevoja të shkollës.	Ndikim mesatar në zvogëlimin e shpenzimit të energjisë dhe kostove për të.	Nxënësit, Këshilli i Shkollës, Komuniteti i Gjerë (Prindërit), Komuna	Vlerësimi i situatës; Kërkesat për veprim tek institucionet relevante; Koordinimi me komunën; Informimi i nxënësve për përdorim racional.
Sistemi i grumbullimit të ujërave atmosferik dhe ndarjes nga kanalizimi	Ndikim i lartë, mundëson shfrytëzim racional të ujit dhe përdorim të tij për nevoja të shkollës (p.sh.ujitje).	Nxënësit, Këshilli i Shkollës, Komuniteti i Gjerë (Prindërit), Komuna	Vlerësimi i situatës; Kërkesat për veprim tek institucionet relevante; Koordinimi me komunën; Informimi i nxënësve për përdorimin adekuat.
Drunjëzimi përreth shtratit të lumit	Shumë i lartë, sidomos në thithjen e ndotësve dhe grimcave të dëmshme si CO2 dhe SO2 dhe parandalimin e erozionit / rrëshqitjes së dheut përgjatë shtratit të lumit.	Nxënësit, Këshilli i Shkollës, Komuniteti i Gjerë(Prindërit), Komuna	Hartimi i planit të mbjelljes (drunjëzimit); Miratimi i tij në këshillin e shkollës; Hartimi i planeve vjetore; Përfshirja e komunitetit; Ndërmarrja e fushatave.
Hapja e Pusit për nevoja të shkollës	I lartë. Mundëson shfrytëzim racional të ujit të pijshëm dhe akumulim të ujit për sezone të thata.	Shkolla, Komuna.	Vlerësimi i situatës; Kërkesat për veprim tek institucionet relevante; Koordinimi me komunën; Informimi i nxënësve për përdorimin adekuat.
Niveli Komunal			
Rregullimi i shtratit të lumit	Parandalon dëmet dhe rreziqet nga uji dhe vërshimet.	Shkolla, Komuna, Ministrinë	Vlerësimi i situatës (në afërsi të vendbanimit dhe shkollës); Kërkesat për veprim tek institucionet relevante (komuna dhe ministrinë); Koordinimi me komunën; Informimi i nxënësve për

DORACAK PËR NJË EKO SHKOLLË

			aspektet e sigurisë gjatë punimeve.
Niveli Rajonal			
Ndërtimi i baseneve akumuluese nëpër rajone.	I lartë përkitazi me rritjen e sigurisë për ujë.	Shkolla, Komuna, Ministrinë, Agjencitë e pavarura, donatorët dhe organizatat zhvillimore.	Vlerësimi i situatës (në afërsi të vendbanimit dhe shkollës); Avokimi publik dhe sy më sy për veprim tek institucionet (komuna dhe ministrinë); Kordinimi me akterët relevant; Informimi i nxënësve dhe komunitetit.
Sistemi i trajtimit të ujërave të zeza.	I lartë në kontekst të parandalimit të ndotjes së lumenjëve.	Shkolla, Komuna, Ministrinë	Vlerësimi i situatës (në afërsi të vendbanimit dhe shkollës); Kërkesat për veprim tek institucionet relevante (komuna dhe ministrinë); Kordinimi me komunën; Informimi i nxënësve për aspektet e sigurisë gjatë punimeve.
Niveli Kombëtar			
Ndërtimi i baseneve akumuluese nëpër rajone.	I lartë përkitazi me rritjen e sigurisë për ujë.	Shkolla, Komuna, Ministrinë, Agjencitë e pavarura, donatorët dhe organizatat zhvillimore.	Vlerësimi i situatës (në afërsi të vendbanimit dhe shkollës); Avokimi publik dhe sy më sy për veprim tek institucionet (komuna dhe ministrinë); Kordinimi me akterët relevant; Informimi i nxënësve dhe komunitetit.

Figura 3. Masat e Parapara për Nën-Temën: Uji

DORACAK PËR NJË EKO SHKOLLË

Shembull i Praktikave të Mira për Masa të Ujit

Titulli i Projektit: Hapja e Pusit për Nevoja të Shkollës

Ndikimi i Praktikës: Shumë i lartë, sidomos në përbushjen e nevojave të shkollës për ujë dhe parandalimin e shpenzimit të ujit të pijshëm për nevoja të tjera si higjiena dhe ujitja/mirëmbajtja e kopshtit. Gjithashtu, mundëson akumulim të ujit për sezone të thata kur shërbimi rajonal është i kufizuar.

Procesi i Mundshëm: Vlerësohet situata dhe nevojat e sakta të shkollës për ujë tani dhe në të tashmen. Në bazë të saj, hartohet plani i veprimit, i cili aprovohet në Këshillin e Shkollës. Plani i aprovuar, shoqërohet me buxhetin tentativ, dhe dorëzohet për financim me një kërkesë/përshkrim të shkurtë të projektit tek burimet e synuara të financimit. Zbatimi dhe mirëmbajtja mund të fillojnë si faza vetëm pasi të jetë siguruar financimi, dhe atë sipas rregullave dhe procedurave të pales financuese. Në rast të financimit vetanak, procedurat dhe procesi definoohen, aprovohen dhe mbikëqyren nga Drejtori dhe Këshilli i Shkollës.

Burimi i Financimit: Varësisht prej vlerës së investimit, financimi mund të kërkohet brenda resurseve vetanake (p.sh. donacione nga prindërit), ose (në rast se tejkalon mundësitë e komunitetit lokal) duke kërkuar përkrahje nga komuna, ministritë, donator ndërkombëtarë, apo edhe komuniteti lokal i biznesit.

Zbatim Gjithëpërfshirës: Është tejet e rëndësishme që gjatë zbatimit (pas sigurimit të financimit), procesit të jetë gjithëpërfshirës. Jashta palëve formale në proces, informimi i nxënësve përmes Eko Klubeve, në zbatimin përdorimin adekuat të ujit dhe kursimin e të njëjtit është jetike për ndërtimin e ndërgjegjes kolektive ambientale dhe përgjegjshmërinë qytetare ndaj ambientit.

Palët në Proces: Në proces rekomandohet të përfshihen jashta anëtarëve të Këshillit Drejtues edhe prindër/anëtarë të komunitetit me përvoja / ekspertiza me rëndësi për projektin (p.sh. hidro-inxhinierë, biznese lokale të hapjes së puseve, etj. Kjo ndikon pozitivisht edhe në ngritjen e nivelit profesional të nismave/projekteve, ashtu ndihmon edhe me rrjetëzim në sektorin relevant.

Figura 4. Shembull i Zbërthyer: Uji

Toka



Ndotja e tokës shkaktohet nga prezenca e materieve kimike të prodhuara nga njeriu, në ambient natyror. Shkaktarët më të shpeshtë të ndotjes janë aktiviteti industrial, kemikatet bujqësore, si dhe hedhja e mbeturinave në mënyrë të gabueshme. Ndotja e tokës mund të ndodhë edhe nga ndotja e burimeve nëntokësore, që mund të vijë si rezultat i rrjedhjeve nga deponitë. Qëllimi i masave brenda kësaj teme është ndërtimi i një kulture kolektive në bashkësi për ruajtjen dhe përmirësimin e hapësirave të përbashkëta duke shtuar hapësirat e gjelbërta, ruajtjen e atyre ekzistuese, si dhe revitalizimin e hapësirave të dëmtuara/ndotura ekologjikisht. Brenda temës së Tokës, përfshihen masat për përdorimin efikas të tokës, ruajtjen, dhe ripërtirjen/rehabilitimin e hapësirave/tokës së ndotur.

Masat brenda kësaj teme përfshijnë edhe veprime që rekomandohen tek temat e tjera si uji dhe ajri (p.sh. mbjellja e drunjëve ndihmon parandalimin e erozionit të tokës në vendet ku ekziston një rrezik i tillë, por edhe në ruajtjen e burimeve nëntokësore të ujit, dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit. Disa tema të tjera brenda temës së tokës, kanë mbi-vendosje edhe me energjinë dhe mbeturina. Gjithashtu, krijimi i Eko-Grupeve të nxënësve që do të përfshihen drejtpërdrejtë në zbatimin e masave të propozuara (si fushata, aksione, etj) është element i përbashkët me temat e tjera.

Masa	Ndikimi	Palët e Përfshira	Hapat
Niveli i Shkollës			
Kompostimi i mbetjeve organike (për shkollat me pemë frutore dhe atyre që	I lartë. Zvogëlimi i sasisë së mbetjeve të deponuar në deponi/landfill.	Nxënësit, Këshilli i Shkollës, Komuniteti i Gjerë(Prindërit), komuna,	Hartimi i planit të veprimit, Miratimi i tij në Këshillin e Shkollës,

DORACAK PËR NJË EKO SHKOLLË

kanë mbetje organike).		ministrinë relevante, Sektori privat.	Kërkesat për veprim tek institucionet relevante (komuna dhe ministrinë); Koordinimi me komunën; Gjetja e donatorëve për investim; Ndërlidhja me komunitetin për të mbledhur mbetjet organike, Promovimi i modelit
Ndarja e mbeturinave	I lartë. Mundëson reciklimin e mbetjeve të reciklueshme.	Nxënësit, Këshilli i Shkollës, Komuniteti i Gjerë(Prindërit), komuna, Sektori privat.	Hartimi i planit të veprimit, Miratimi i tij në Këshillin e Shkollës, Kërkesat për veprim tek institucionet relevante (komuna dhe ministrinë); Koordinimi me komunën; Ndërlidhja me komunitetin dhe bizneset recikluese, Promovimi i modelit
Drunjëzimi përreth shtratit të lumit	Shumë i lartë, sidomos në thithjen e ndotësve dhe grimcave të dëmshme si CO2 dhe SO2 dhe parandalimin e erozionit / rrëshqitjes së dheut përgjatë shtratit të lumit.	Nxënësit, Këshilli i Shkollës, Komuniteti i Gjerë(Prindërit), komuna, ministrinë relevante.	Hartimi i planit të mbjelljes (drunjëzimit), Miratimi i tij në këshillin e shkollës, Hartimi i planeve vjetore Përfshirja e komunitetit Ndërmarrja e fushatave
Niveli Komunal			
Rregullimi i shtratit të lumit	Parandalon dëmet dhe rreziqet nga uji dhe vërshimet.	Shkolla, Komuna, Ministrinë	Vlerësimi i situatës (në afërsi të vendbanimit dhe shkollës); Kërkesat për veprim tek institucionet relevante (komuna dhe ministrinë); Koordinimi me komunën; Informimi i nxënësve për aspektet e sigurisë gjatë punimeve.
Investimi në hapësira të gjelbërta dhe drunjëzime.	Planifikimi dhe zbatimi i projekteve të drunjëzimit shihet si një prej masave më efektive të luftimit të ngrohjes globale dhe ndryshimeve klimatike.	Komuna, MMPH, MAPL, Agjencia e Pyjeve, Nxënësit Komuniteti,	Zhvillimi i planit të mbjelljes (drunjëzimit); Miratimi i tij në Këshillin Drejtues të shkollës; Hartimi i planeve vjetore; Përfshirja e komunitetit; Ndërmarrja e fushatave.
Eliminimi i deponive ilegale	E lartë sidomos në eliminimin e erërave të pakëndshme përreth shkollave dhe vendbanimeve që vijnë nga deponi ilegale.	Komuna, Nxënësit dhe Komuniteti, OJQ-të ambientale, Kompania Rajonale e Menaxhimit të mbeturinave, inspektoratet, policia.	Vlerësimi i situatës dhe identifikimi i zonave me deponi ilegale; Kërkesat për veprim tek institucionet relevante; Koordinimi me komunën dhe policinë pas ndërtimit të infrastrukturës dhe shënjimit adekuat; Organizimi i aksioneve të pastrimit me nxënës.
Mbulueshmëri 100% e qytetarëve me shërbime grumbullimi të mbeturinave.	I lartë. Mundëson ndërtimin e një sistemi të qëndrueshëm parandalimin e përkeqësimit të ndotjes nga mbeturinat, dhe hap rrugë për trajtimin e mbeturinave të vjetra në	Nxënësit, Këshilli i Shkollës, Komuniteti i Gjerë(Prindërit), komuna, Sektori privat.	Hartimi i planit të veprimit, Miratimi i tij në Këshillin e Shkollës, Kërkesat për veprim tek institucionet relevante (komuna dhe ministrinë); Koordinimi me komunën;

DORACAK PËR NJË EKO SHKOLLË

	landfile që kontaminojnë token.		Ndërlidhja me komunitetin dhe bizneset recikluese, Promovimi i modelit
Niveli Rajonal			
Planet zhvillimore dhe hapësinore	Shumë ndikim të lartë pasi apracakton destinimin e territorit/tokës dhe shfrytëzimin racional të saj.	Komuna, Nxënësit dhe Komuniteti, OJQ-të ambientale, Kompania Rajonale e Menaxhimit të mbeturinave, inspektoratet, policia.	Vlerësimi i situatës (në afërsi të vendbanimit dhe shkollës); Kërkesat për veprim tek institucionet relevante (komuna dhe ministritë); Koordinimi me komunën; Peticione dhe kërkesa ndaj institucioneve relevante komunale dhe qendrore.
Niveli Kombëtar			
Mbrojtja më efikase e pyjeve	Shumë ndikim të lartë sidomos në parandalimin e përkeqësimit të situatës me pyjet publike.	Komuna, Nxënësit dhe Komuniteti, OJQ-të ambientale, Agjencia e Menaxhimit të Pyjeve, inspektoratet, policia.	Vlerësimi i situatës (në afërsi të vendbanimit dhe shkollës); Kërkesat për veprim tek institucionet relevante (komuna dhe ministritë); Koordinimi me komunën; Peticione dhe kërkesa ndaj institucioneve relevante komunale dhe qendrore; Organizimi i vëzhguesve të komunitet për të raportuar rastet e prerjeve.
Programe kthimi në komunitet për prerësit ilegal të drunjëve	Shumë ndikim të lartë sidomos në parandalimin e përkeqësimit të situatës me pyjet publike. Specifikisht, ndikon në zvogëlimin e recidivizmit tek prerësit ilegal të drunjëve.	Komuna, Nxënësit dhe Komuniteti, OJQ-të ambientale, Agjencia e Menaxhimit të Pyjeve, inspektoratet, policia, gjykatat, ministria e drejtësisë	Kërkesat për veprim tek institucionet relevante (komuna dhe ministritë); Koordinimi me komunën; Peticione dhe kërkesa ndaj institucioneve relevante komunale dhe qendrore; Avokimi për ndryshim.

Figura 5. Masat e Parapara për Nën-Temën: Toka

Shembull i Praktikave të Mira për Masa të Tokës

Titulli i Projektit: Kompostimi i Mbeturave Organike

Ndikimi i Praktikës: Kjo masë ka ndikim të lartë sidomos në zvogëlimin e sasisë së mbetjeve në deponi. Projekti është i përshtatshëm për shkolla që kanë pemë frutore në oborret e tyre, apo edhe mbetje të tjera organike (nga kuzhina, mbetje ushqimore etj.)

Procesi i Mundshëm: Vlerësohet situata dhe nevojat e sakta të shkollës për kompostim të mbeturave organike, përfshirë sasinë e mbeturave të prodhuar mesatarisht, si dhe nevojën për shporta për reciklim. Në bazë të saj, hartohet plani i veprimit, i cili aprovohet në Këshillin e Shkollës. Plani i aprovuar, shoqërohet me buxhetin tentativ, dhe dorëzohet për financim me një kërkesë/përshkrim të shkurtër të projektit tek burimet e synuara të financimit. Zbatimi dhe mirëmbajtja mund të fillojnë si faza vetëm pasi të jetë siguruar financimi, dhe atë sipas rregullave dhe procedurave të pales financuese. Në rast të financimit vetanak, procedurat dhe procesi definohej, aprovohen dhe mbikëqyren nga Drejtori dhe Këshilli i Shkollës. Edukimi i nxënësve dhe mësimeve për ndarjen dhe kompostimin e mbeturave është gjithashtu thelbësor për realizimin e suksesshëm të kësaj insme dhe krijimin e kulturës së përgjegjshmërisë ambientale.

Burimi i Financimit: Financimi mund të kërkohej brenda komunitetit (p.sh. donacione nga prindërit), ose (në rast se tejkalon mundësitë e komunitetit lokal) duke kërkuar përkrahje nga komuna, ministritë, donator ndërkombëtarë, apo edhe komuniteti lokal i biznesit. Kompanitë private në fushën e reciklimit gjithashtu mund të kontaktohen si burim i mundshëm i financimit pasi kjo praktikë ndikon në zgjerimin e aktivitetit të këtyre bizneseve dhe gadishmëria për të investuar në grumbullim të ndarë të mbeturave është atraktive.

Zbatim Gjithëpërfshirës: Është tejet e rëndësishme që gjatë zbatimit, proceset të jetë gjithëpërfshirëse. përveç palëve formale në proces, informimi i nxënësve përmes Eko Klubeve, në ndarjen adekuate të mbeturave, është jetike për ndërtimin e një sistemi funksional të kompostimit.

Palët në Proces: Në proces rekomandohet të përfshihen jashta anëtarëve të Këshillit Drejtues edhe prindër/anëtarë të komunitetit me përvoja / ekspertiza me rëndësi për projektin (p.sh. inxhinierë ambiental, biznese lokale të reciklimit, etj. Kjo ndikon pozitivisht edhe në ngritjen e nivelit profesional të nismave/projekteve, ashtu ndihmon edhe me rrjetëzim në sektorin relevant dhe realizim më të lehtë të aktiviteteve.

Figura 6 Shembull i Zbërthyer: Toka

DORACAK PËR NJË EKO SHKOLLË

Mbeturinat



Njerëzimi, për shkak të mënyrës së jetesës dhe organizimit, si dhe proceseve transformuese shoqërore si industrializimi, është duke krijuar më shumë mbeturina se sa që natyra mund të përballojë, dhe në disa raste ka shkatërruar ekosisteme të tëra. Mbetjet e ngurta, gazërat, si dhe mbetjet e lëngshme, të gjitha mund të shkaktojnë probleme serioze për shëndetin e njeriut nëse nuk trajtohen, transportohen dhe menaxhohen në mënyrë adekuate. Disa lloje të mbeturinave janë

veçanërisht të rrezikshme për natyrën dhe njeriun si ato biologjike, kimike, dhe radioaktive. Kjo temë mbulon masa që çojnë në menaxhimin e qëndrueshëm të mbeturinave si masa për ndarjen, reciklimin, dhe ri-përdorimin e mbetjeve. Një pjesë të mirë të popullsisë dhe banorëve në Komunën e Prizrenit, ngjashëm me pjesët e tjera të Kosovës, nuk i ofrohet shërbimi i grumbullimit të mbeturinave nga kompanitë rajonale përgjegjëse. Në mungesë të mekanizmave dhe shërbimeve publike të grumbullimit të ndarë të mbeturinave, lind nevoja për ndërlidhje me zinxhirët jo-formal të reciklimit (grumbulluesit individual), apo bizneset në sektorin e reciklimit, si pikat grumbulluese. Ndërtimi i një vetëdije shoqërore rreth zvogëlimin të sasisë së mbeturinave të prodhuara përmes ri-përdorimit, ndarjes, dhe reciklimit të materialeve është esenciale për zvogëlimin e efekteve negative në ambient dhe shëndet. Gjithashtu, masat efektive përfshijnë trajtimin e mbetjeve (p.sh. incinerim/djegje, për të përmbushur nevojat e ngrohjes, ujit të ngrohtë, apo energjisë).

Masa	Ndikimi	Palët e Përfshira	Hapat
Niveli i Shkollës			
Ndarja e mbeturinave	I lartë. Mundëson reciklimin e mbetjeve të riciklueshme.	Nxënësit, Këshilli i Shkollës, Komuniteti i Gjerë(Prindërit), komuna, Sektori privat.	Hartimi i planit të veprimit, Miratimi i tij në Këshillin e Shkollës, Kërkesat për veprim tek institucionet relevante (komuna); Koordinimi me komunën; Ndërlidhja me komunitetin dhe bizneset ricikluese, Promovimi i modelit
Reciklimi i mbetjeve të riciklueshme.	I lartë. Mundëson reciklimin e mbetjeve të riciklueshme.	Nxënësit, Këshilli i Shkollës, Komuniteti i Gjerë(Prindërit), komuna, Sektori privat.	Hartimi i planit të veprimit, Miratimi i tij në Këshillin e Shkollës, Kërkesat për veprim tek institucionet relevante (komuna dhe ministritë); Koordinimi me komunën; Ndërlidhja me komunitetin dhe bizneset ricikluese, Promovimi i modelit
Ri-përdorimi i resurseve.	I lartë. Mundëson Ri-përdorimin e mbetjeve që mund t'ju ndërrohet destinimi/funksioni.	Nxënësit, Këshilli i Shkollës, Komuniteti i Gjerë(Prindërit), komuna, Sektori privat.	Hartimi i planit të veprimit, Miratimi i tij në Këshillin e Shkollës, Kërkesat për veprim tek institucionet relevante (komuna dhe ministritë); Ndërlidhja me komunitetin dhe bizneset, Promovimi i modelit
Organizimi i aksioneve të pastrimit.	E lartë sidomos në eliminimin e erërave të pakëndshme përreth shkollave dhe	Komuna, Nxënësit dhe Komuniteti, OJQ-të ambientale, Kompania Rajonale e	Vlerësimi i situatës dhe identifikimi i zonave me deponi ilegale; Kërkesat për veprim tek

DORACAK PËR NJË EKO SHKOLLË

	vendbanimeve që vijnë nga deponi ilegale.	Menaxhimit të mbeturinave, inspektoratet, policia.	institucionet relevante; Kordinimi me komunën dhe policinë pas ndërtimit të infrastrukturës dhe shënjimit adekuat; Organizimi i aksioneve të pastrimit me nxënës.
Niveli Komunal			
Bashkëpunimi me komunitet për kompostim.	I lartë. Zvogëlimi i sasisë së deponuar në deponi/landfill.	Nxënësit, Këshilli i Shkollës, Komuniteti i Gjerë(Prindërit), komuna, ministritë relevante, Sektori privat.	Hartimi i planit të veprimit, Miratimi i tij në Këshillin e Shkollës, Kërkesat për veprim tek institucionet relevante (komuna dhe ministritë); Kordinimi me komunën; Gjetja e donatorëve për investim; Ndërlidhja me komunitetin për të mbledhur mbetjet organike, Promovimi i modelit
Reciklimi i mbetjeve të riciklueshme.	I lartë. Mundëson reciklimin e mbetjeve të riciklueshme.	Nxënësit, Këshilli i Shkollës, Komuniteti i Gjerë(Prindërit), komuna, Sektori privat.	Hartimi i planit të veprimit, Miratimi i tij në Këshillin e Shkollës, Kërkesat për veprim tek institucionet relevante (komuna dhe ministritë); Kordinimi me komunën; Ndërlidhja me komunitetin dhe bizneset recikluese, Promovimi i modelit
Organizimi i aksioneve të pastrimit.	E lartë sidomos në eliminimin e erërave të pakëndshme përreth shkollave dhe vendbanimeve që vijnë nga deponi ilegale.	Komuna, Nxënësit dhe Komuniteti, OJQ-të ambientale, Kompania Rajonale e Menaxhimit të mbeturinave, inspektoratet, policia.	Vlerësimi i situates dhe identifikimi i zonave me deponi ilegale; Kërkesat për veprim tek institucionet relevante; Kordinimi me komunën dhe policinë pas ndërtimit të infrastrukturës dhe shënjimit adekuat; Organizimi i aksioneve të pastrimit me nxënës.
Niveli Rajonal			
Investime në kapacitete të gjenerimit përmes incinerimit/djegies së mbeturinave	I lartë. Mund të zvogëlojë sasinë e mbetjeve të deponuara në landfile deri në 80% varësisht nga efienca e teknologjisë.	Shkolla, Komuna, Ministritë relevante, ZRRE, donatorët potencialë.	Kërkesat për veprim tek institucionet relevante; Kordinimi me komunën; Përfshirja e komunitetit; Ndërmarrja e fushatave.
Trajtimi i deponive legale dhe legale	E lartë sidomos në eliminimin e erërave të pakëndshme përreth shkollave dhe vendbanimeve që vijnë nga deponi ilegale.	Komuna, Nxënësit dhe Komuniteti, OJQ-të ambientale, Kompania Rajonale e Menaxhimit të mbeturinave, inspektoratet, policia.	Vlerësimi i situates dhe identifikimi i zonave me deponi ilegale; Kërkesat për veprim tek institucionet relevante; Kordinimi me komunën dhe policinë pas ndërtimit të infrastrukturës dhe shënjimit adekuat; Organizimi i aksioneve të pastrimit me nxënës.
Niveli Kombëtar			
Investime në kapacitete të gjenerimit përmes incinerimit/djegies së	I lartë. Mund të zvogëlojë deri në 80% sasinë e mbeturinave në deponi	Shkolla, Komuna, Ministritë relevante, ZRRE, donatorët potencialë.	Kërkesat për veprim tek institucionet relevante; Kordinimi me komunën;

DORACAK PËR NJË EKO SHKOLLË

mbeturinave	varësisht nga efienca e teknologjisë.		Përfshirja e komunitetit; Ndërmarrja e fushatave.
Trajtimi i deponive legale dhe legale	I lartë. Parandalon ndotjen e mëtutjeshme të shkaktuar nga deponitë e egra.	Shkolla, Komuna, Ministrinë relevante, ZRRE, donatorët potencialë.	Kërkesat për veprim tek institucionet relevante; Koordinimi me komunën; Përfshirja e komunitetit; Ndërmarrja e fushatave.

Figura 7. Masat e Parapara për Nën-Temën: Mbeturinave

Shembull i Praktikave të Mira për Masa të Mbeturinave

Titulli i Projektit: Ndarja e Mbeturinave

Ndikimi i Praktikës: Shumë i lartë, sidomos në parandalimin e mëtutjeshëm të tokës pasi mundëson reciklimin e mbetjeve të reciklueshme dhe zvogëlimin e sasisë së mbeturinave në deponi.

Procesi i Mundshëm: Vlerësohet situata dhe nevojat e sakta të shkollës për ndarje/menaxhim të mbeturinave, përfshirë sasinë e mbeturinave të prodhuar mesatarisht, si dhe nevojën për shporta për reciklim. Në bazë të saj, hartohet plani i veprimit, i cili aprovohet në Këshillin e Shkollës. Plani i aprovuar, shoqërohet me buxhetin tentativ, dhe dorëzohet për financim me një kërkesë/përshkrim të shkurtë të projektit tek burimet e synuara të financimit. Zbatimi dhe mirëmbajtja mund të fillojnë si faza vetëm pasi të jetë siguruar financimi, dhe atë sipas rregullave dhe procedurave të pales financuese. Në rast të financimit vetanak, procedurat dhe procesi definohej, aprovohen dhe mbikëqyren nga Drejtori dhe Këshilli i Shkollës. Edukimi i nxënësve dhe mësimeve për ndarjen e mbeturinave në burim është gjithashtu thelbësor për realizimin e suksesshëm të kësaj insme dhe krijimin e kulturës së përgjegjshmërisë ambientale.

Burimi i Financimit: Varësisht prej vlerës së investimit, financimi mund të kërkohet brenda resurseve vetanake (p.sh. donacione nga prindërit), ose (në rast se tejkalon mundësitë e komunitetit lokal) duke kërkuar përkrahje nga komuna, ministrinë, donator ndërkombëtarë, apo edhe komuniteti lokal i biznesit. Kompanitë private në fushën e reciklimit gjithashtu mund të kontaktohen si burim i mundshëm i financimit pasi kjo praktikë ndikon në zgjerimin e aktivitetit të këtyre bizneseve dhe gadishmëria për të investuar në grumbullim të ndarë të mbeturinave është atraktive.

Zbatim Gjithëpërfshirës: Është tejet e rëndësishme që gjatë zbatimit (pas sigurimit të financimit), procesit të jetë gjithëpërfshirës. Jashta palëve formale në proces, informimi i nxënësve përmes Eko Klubeve, në hudhjen adekuate të mbeturinave, është jetike për ndërtimin e ndërgjegjes kolektive ambientale dhe përgjegjshmërinë qytetare ndaj ambientit.

Palët në Proces: Në proces rekomandohet të përfshihen jashta anëtarëve të Këshillit Drejtues edhe prindër/anëtarë të komunitetit me përvoja / ekspertiza me rëndësi për projektin (p.sh. inxhinierë ambiental, biznese lokale të reciklimit, etj. Kjo ndikon pozitivisht edhe në ngritjen e nivelit profesional të nismave/projekteve, ashtu ndihmon edhe me rrjetëzim në sektorin relevant dhe realizim më të lehtë të aktiviteteve.

Figura 8. Shembull i Zbërthyer: Mbeturinave

DORACAK PËR NJË EKO SHKOLLË

Energjia



Auditimi i burimeve të energjisë, shfrytëzimi racional, si dhe zberthimi i masave që kursejnë energjinë të gjitha parashihen brenda temës së energjisë në funksion të zvogëlimit të ndotjes dhe kostos. Shfrytëzimi i energjisë gjithashtu përbëhet nga dy dimensione atij të shfrytëzimit të burimeve të ri-përtrishme të energjisë (diellit, erës), si dhe masave të efijencës së energjisë si izolimet, ndriçime automatike, pajisje me efijencë të lartë, izolimet e ndërtesave etj. Masa të bazuara në teknologjinë bashkëkohore si zbehësit e dritave elektrike të cilët zvogëlojnë shfrytëzimin e energjisë duke lëjuar dritave të veprojnë me intensitet më të ulët, por njëherit e zgjasin edhe

jetëgjatësinë e tyre. Edhe brenda kësaj teme disa prej masave ndërlihen me institucione në nivel komunal dhe kombëtar.

Masa	Ndikimi	Palët e Përfshira	Hapat
Niveli i Shkollës			
Izolimi i ambienteve.	I lartë. Mund të kursejë shumë për energjinë e shpenzuar për ngrohje gjatë sezonit të ftohtë	Shkolla, Komuna, Ministrinë relevante, donatorët potencialë.	Vlerësimi i situates; Zhvillimi i planit të veprimit; Miratimi i tij në Këshillin Drejtues të shkollës; Kërkesat për veprim tek institucionet relevante; Koordinimi me komunën; Përfshirja e komunitetit; Ndërmarrja e fushatave.
Instalimi i sistemeve dhe pajisje me konsum të ultë të energjisë	Mund të kursejë shumë për energjinë e shpenzuar	Shkolla, Komuna, Ministrinë relevante, donatorët potencialë.	Vlerësimi i situates; Zhvillimi i planit të veprimit; Miratimi i tij në Këshillin Drejtues të shkollës; Kërkesat për veprim tek institucionet relevante; Koordinimi me komunën; Përfshirja e komunitetit; Ndërmarrja e fushatave.
Instalimi i pajisjeve për gjenerim (solare) në kulmin e shkollës.	I lartë. Mund të kursejë deri në 40% të energjisë së shpenzuar për rrymë.	Shkolla, Komuna, Ministrinë relevante, donatorët potencialë.	Vlerësimi i situates; Zhvillimi i planit të veprimit; Miratimi i tij në Këshillin Drejtues të shkollës; Kërkesat për veprim tek institucionet relevante; Koordinimi me komunën; Përfshirja e komunitetit; Ndërmarrja e fushatave.
Instalimi i sensorëve me lëvizje për ndriçim.	I lartë. Mund të kursejë energjinë e shpenzuar për ndriçim.	Shkolla, Komuna, Ministrinë relevante, donatorët potencialë.	Vlerësimi i situates; Zhvillimi i planit të veprimit; Miratimi i tij në Këshillin Drejtues të shkollës; Kërkesat për veprim tek institucionet relevante; Koordinimi me komunën; Përfshirja e komunitetit; Ndërmarrja e fushatave.
Instalimi i 'zbehësve' (dimers) për ndriçim.	I lartë. Mund të kursejë energjinë e shpenzuar për ndriçim	Shkolla, Komuna, Ministrinë relevante, donatorët potencialë.	Vlerësimi i situates; Zhvillimi i planit të veprimit; Miratimi i tij në Këshillin Drejtues të shkollës; Kërkesat për veprim tek institucionet relevante; Koordinimi me komunën; Përfshirja e komunitetit; Ndërmarrja e fushatave.
Niveli Komunal			
Përdorimi i burimeve më	I lartë. Zvogëlon dukshëm	Shkolla, Komuna,	Vlerësimi i situates;

DORACAK PËR NJË EKO SHKOLLË

pak të dëmshme të energjisë për ngrohje.	nivelin lokal të ndotjes sidomos gjatë stinës së ftohtë.	Ministritë relevante, donatorët potencialë.	Zhvillimi i planit të veprimit; Miratimi i tij në Këshillin Drejtues të shkollës; Kërkesat për veprim tek institucionet relevante; Koordinimi me komunën; Përfshirja e komunitetit; Ndërmarrja e fushatave.
Ndalesa e përdorimit të thëngjillit për ngrohje të amvisërive	I lartë. Zvogëlon dukshëm nivelin lokal të ndotjes sidomos gjatë stinës së ftohtë.	Shkolla, Komuna, Ministritë relevante, donatorët potencialë.	Vlerësimi i situates; Zhvillimi i planit të veprimit; Miratimi i tij në Këshillin Drejtues të shkollës; Kërkesat për veprim tek institucionet relevante; Koordinimi me komunën; Përfshirja e komunitetit; Ndërmarrja e fushatave.
Ndriçimi publik me burime të ripërtërishme	I lartë. Mund të kursejë deri në 30% të energjisë së shpenzuar për ndriçim publik.	Shkolla, Komuna, Ministritë relevante, donatorët potencialë.	Vlerësimi i situates; Zhvillimi i planit të veprimit; Miratimi i tij në Këshillin Drejtues të shkollës; Kërkesat për veprim tek institucionet relevante; Koordinimi me komunën; Përfshirja e komunitetit; Ndërmarrja e fushatave.
Niveli Rajonal			
Investime në kapacitete të gjenerimit përmes incinerimit/djegies së mbeturinave	I lartë. Mund të zvogëlojë sasinë e mbetjeve të deponuara në landfile deri në 80% varësisht nga efienca e teknologjisë.	Shkolla, Komuna, Ministritë relevante, ZRRE, donatorët potencialë.	Kërkesat për veprim tek institucionet relevante; Koordinimi me komunën; Përfshirja e komunitetit; Ndërmarrja e fushatave.
Niveli Kombëtar			
Incentiva dhe subvencione për projekte të efqencës së energjisë dhe burimeve të ripërtërishme	I lartë. Mund të zvogëlojë emetimet e CO2 dhe SO2 për prodhim energjie varësisht nga efienca e teknologjisë.	Shkolla, Komuna, Ministritë relevante, ZRRE, donatorët potencialë.	Kërkesat për veprim tek institucionet relevante; Koordinimi me komunën; Përfshirja e komunitetit; Ndërmarrja e fushatave.

Figura 9. Masat e Parapara për Nën-Temën: Energjia

Shembull i Praktikave të Mira për Masa të Energjisë

Titulli i Projektit: Instalimi i Sensorëve me Lëvizje për Ndrçim Efikas

Ndikimi i Praktikës: Shumë i lartë, sidomos në parandalimin e shpenzimit të panevojshëm të energjisë përmes ndriçimit të kotë të hapësirave. Kjo teknologji bazohet në sensorë që detektojnë lëvizjen dhe aktivizojnë dritat vetëm në vendet ku ka aktivitet fizik (lëvizje) dhe duke lënë të errëta hapësirat ku nuk ka lëvizje dhe rrjedhimisht nuk ka nevojë për ndriçim. Kjo masë ndikon në kursimin e energjisë si dhe në jetëgjatësinë e pajisjeve të sistemit pasi zvogëlon përdorimin e tyre.

Procesi i Mundshëm: Vlerësohet situata dhe nevojat e sakta të shkollës për ndriçim, përfshirë numrin e hapësirave ku do të vendosen sensorë. Në bazë të saj, hartohet plani i veprimt, i cili aprovohet në Këshillin e Shkollës. Planin i aprovuar, shoqërohet me buxhetin tentativ, dhe dorëzohet për financim me një kërkesë/përshkrim të shkurtë të projektit tek burimet e synuara të financimit. Zbatimi dhe mirëmbajtja mund të fillojnë si faza vetëm pasi të jetë siguruar financimi, dhe atë sipas rregullave dhe procedurave të pales financuese. Në rast të financimit vetanak, procedurat dhe procesi definohe, aprovohen dhe mbikëqyren nga Drejtori dhe Këshilli i Shkollës. Edukimi i nxënësve dhe mësimeve për ndarjen e mbeturinave në burim është gjithashtu thelbësor për realizimin e suksesshëm të kësaj insme dhe krijimin e kulturës së përgjegjshmërisë ambientale.

Burimi i Financimit: Varësisht prej vlerës së investimit, financimi mund të kërkohet brenda resurseve vetanake (p.sh. donacione nga prindërit), ose (në rast se tejkalo mundësitë e komunitetit lokal) duke kërkuar përkrahje nga komuna, ministritë, donator ndërkombëtarë, apo edhe komuniteti lokal i biznesit. Kompanitë private në fushën e reciklimit gjithashtu mund të kontaktohen si burim i mundshëm i financimit pasi kjo praktikë ndikon në zgjerimin e aktivitetit të këtyre bizneseve dhe gadishmëria për të investuar në grumbullim të ndarë të mbeturinave është atraktive.

Zbatim Gjithëpërfshirës: realit projekteve të kësaj natyre është mët I kufizuar se tek nismat e tjera tëpropozuara, por promovimi I intervenimit tek komuniteti I gjerë duhet tëjetë aktiv dhe të motivojë edhe komunitetin të ndërmarrë veprime tëtolla në amvisëritë e tyre.

Palët në Proces: Në proces rekomandohet të përfshihen jashta anëtarëve të Këshillit Drejtues edhe prindër/anëtarë të komunitetit me përvoja / ekspertiza me rëndësi për projektin (p.sh. elektro-inxhinierë, biznese lokale të instalimeve elektrike, etj. Kjo ndikon pozitivisht edhe në ngritjen e nivelit profesional të nismave/projekteve, ashtu ndihmon edhe me rjetëzim në sektorin relevant dhe realizim më të lehtë të aktiviteteve

Figura 10. Shembull i Zbërthyer: Energjia

DORACAK PËR NJË EKO SHKOLLË

ROLI I KOMUNITETIT

Përfshirja e Këshillit të Shkollës

Sipas [UA 03.2016](#) të MASHT, Këshilli Drejtues i Shkollës është organi më i lartë këshilldhënës dhe vendimmarrës i Shkollës. Përbërja e tij nga tre prindër, dy përfaqësues të komunës, dhe tre mësimdhënësve e bën Këshillin Drejtues të Shkollës organin më gjithëpërfshirës dhe në të njejtën kohë, më adekuat për ndërmarrjen e veprimeve që shtrihen përtej kompetencave të ngushta të shkollës. Përfshirja e prindërve, arsimtarëve, dhe përfaqësuesve të komunës me përvojë/ekspertizë në ndonjërin nga fushat e intervenimit për eko shkolla do të ishte një pikënisje e mire për të siguruar ekspertizë përbrenda vendim-marrjes në shkollë.

Në mënyrë që të kemi përkrahje qenësore dhe në momentet kur ajo është më e nevojshme, kërkesat për përkrahje duhet të jenë racionale dhe të menduara mirë. Përfshirja e Këshillit Drejtues të Shkollës duhet sa më shumë të kanalizohet në mbledhjet e rregullta dhe sa më pak përmes kërkesave ad-hoc, duke u fokusuar kështu në planifikim të detajuar paraprak. Një praktikë e mirë e kanalizimit të çështjeve dhe prioriteteve është krijimi i task-force të përhershme dhe përkohëshme tematike që përfshijnë grupe më të vogla dhe funksionale që krijohen dhe veprojnë me mandat nga Këshilli.

Përfshirja e Këshillit Drejtues është e rekomanduar të bëhet në tre nivele:

Vendim-Marrje:

- **Strukturimi i planeve afat-mesme dhe vjetore të veprimit**, mundëson strukturimin e proceseve dhe nismave dhe efektivitet më të lartë përmes; kur ato vendosen bashkërisht reflektojnë pritje të përbashkëta rreth kohështirjes dhe rezultateve të pritura si dhe kontributin nga secila palë.
- **Vendim-Marrja Përfaqësuese në Këshillin Drejtues**, mundëson përfshirjen e prioriteteve dhe këndvështrimeve të palëve me interes në nisma të përbashkëta duke rritur kështu pronësinë e përbashkët mbi to; kur prioritetet e secilës palë konsiderohen me të njejtën peshë dhe në mënyrë të paanshme, edhe mobilizimi i tyre është më i lehtë pasi të jetë marrë vendimi. Votimi është mënyra më e drejtë për të reflektuar barazinë e anëtarëve.
- **Vendosja e përbashkët e prioriteteve**, mundëson krijimin e kohezionit brenda Këshillit dhe udhëheqje gjithëpërfshirëse që merr parasysh interesat dhe perspektivat e të gjitha palëve të përfaqësuara në Këshill.

Ekspertizë dhe Rrjetëzim:

- **Përzgjedhja e Anëtarëve me Ekspertizë të ndryshme**, mundëson know-how në më shumë tema dhe sektorë. Kjo shërben si një bazë e mirë për të pasur ekspertizë profesionale në vendim-marrje, si dhe në planifikim të intervenimeve (kohëzgjatje, ligjore, kosto, plane ideore, etj.). Përfshirja në këtë nivel bëhet e pjesëshme (vetëm anëtarët me ekspertizën e kërkuar) duke shfrytëzuar kështu efektivisht kohën e tyre. Anëtarët me ekspertizë të tjera (p.sh. dizajn, gazetari, etj.) mund të përdoren gjatë veprimeve dhe komunikimeve publike për të funksionalizuar aktivitetet maksimalisht drejt qëllimeve të përbashkëta.
 - **Rrjetëzimet profesionale dhe personale**, që burojnë nga diversiteti i Anëtarëve, janë një asset tjetër shumë i vlefshëm që Këshilli përfaqëson. Përfaqësimi i profesioneve dhe ai gjeografik mundëson qasje më të zgjeruar në njerëz dhe rrjete profesionale.
 - **Angazhimi i Personave Publik**, është një aspekt tjetër ku Këshilli mund të angazhohet sipas nevojës. Qoftë për nisma publike apo për të ngritur vetëdijen e vendim-marrësve rreth çështjeve të shkollës, përdorimi i Personave Publik me audience të gjera është mjet efektiv. Identifikimi i personave të tillë përmes rrjeteve personale të anëtarëve është mjaft efikas në Kosovë, marrë parasysh madhësinë e vendit.
-

DORACAK PËR NJË EKO SHKOLLË

Veprim dhe Angazhim Kolektiv:

- **Shpërndarje Informacioni/Informim**, tek prindërit e tjerë, grupet e tyre sociale dhe komuniteti i gjerë. Këto angazhime/veprime duhet të jenë të kufizuara në numër pasi njerëzit shpesh hezitojnë të shpërndajnë informata/njoftime publike. Ato duhet të kufizohen në thirrje për mobilizim dhe veprim për ngjarje të organizuara në shkollë dhe nga shkolla dhe jo për informacion të përgjithshëm.
- **Veprime Kolektive (Edukim, Ndërgjegjësim, Peticione, etj.)**, në rastet kur ka të bëjë me veprime konkrete dhe të nevojshme, Këshilli duhet të udhëheqë veprimin kolektiv, fillimisht përmes vendimit formal për veprim, e më pas dhe në praktike. Harmonizim dhe ndarje të përgjegjësiave me këshillat e tjerë të shkollës për të siguruar shtrirje më të gjerë dhe efektivitet të veprimit.
- **Veprimet / Aksionet në Terren**, sidomos ato të veprimit kolektiv kërkojnë angazhim të gjithmbarshëm të Këshillit dhe mobilizim të të gjithë akterëve të përfaqësuar aty. Pa përfshirjen kuptimplotë të të gjithë anëtarëve të tyre, edhe mobilizimi i resurseve dhe përkrahjes brenda grupeve që ata përfaqësojnë bëhet i pamundur.

Përfshirja e Komunitetit të Gjerë

Përfshirja e komunitetit të gjerë është esenciale në rastet kur synojnë ndryshim të sjelljes dhe / apo vetëdijes kolektive rreth një çështjeje, problemi, apo prioriteti. Aksionet/Veprimet kolektive të pastrimit që përfshijnë komunitetin e gjerë kanë më shumë gjasa që të jenë të qëndrueshme dhe të çojnë në sjellje të ndryshuar tek qytetarët e pandërgjegjshëm që janë shaktarë të ndotjes. Njëjtë veprimet kolektive të drunjëzimit kanë më shumë gjasa të jenë të qëndrueshme dhe të mos dëmtohen në rast se sigurohet pjesëmarrja (qoftë edhe përmes punës vullnetare) e komunitetit të gjerë.

Avokimi për Nisma që Tejkalojnë Kompetencat e Shkollës

Asnjë nismë nuk është shumë e madhe apo e komplikuar nëse bashkërendohen njerëzit me vullnet të mirë dhe punojnë bashkërisht për të zgjidhur problemin. Duke qenë se një pjesë e mirë e masave të sygjera në këtë doracak, tejkalojnë kompetencat dhe mundësitë vetanake të investimit, avokimi pranë palëve të treta në nivel lokal dhe qendror është i domosdoshëm për tejkalimin e suksesshëm të sfidave për zhvillim të qëndrueshëm. Në këtë kontekst, avokimi kthehet në mjet kyç për realizimin me sukses të transformimit në EKO shkollë, pasi që ndërtimi i partneriteteve dhe 'miqësive' ndër-sektoriale dhe grumbullimi i përkrahjes tek komuniteti dhe vendim-marrësit është elementi jetik për realizimin e qëllimit.

Disa praktika të mira të nismave të suksesshme avokuese tregojnë për rëndësinë e ndërtimit të përkrahjes lokale, para se nismat të jetësohen. Ndërtimi i bazës lokale të përkrahjes krijon parakushtin themelor për avancimin e qëllimeve të avokimit. [Ndërtimi i partneriteteve](#) përtej sektorëve është edhe një prej [Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm](#) të OKB, duke u ofruar nganjëherë si shtegu i vetëm për tejkalimin e sfidave të përbashkëta. Ndërtimi i përkrahjes për nisma pozitive për shkollën dhe komunitetin falë teknologjisë modern është bërë më i lehtë. Peticionet [online dhe pa kosto](#) për çështje të komunitetit dhe shoqërisë, që mund të shpërndahen lehtësisht përmes mediave elektronike, portaleve, si dhe rrjeteve sociale, e bën priorizimin e çështjeve për të cilat avokojmë më lehtë. Krijimi i faqeve dhe grupeve në rrjete sociale, gjithashtu ndihmon në çështje të organizimit në praktikë të aksioneve dhe veprimeve dhe për shpërndarje të informacionit rreth rezultateve/progresit të nismës.

Takime me komunitetin (prindërit) dhe vizita personale tek individët e shquar të komunitetit gjithashtu rrisin përkrahjen lokale dhe përfshirjen e personave që nuk përdorin platformat teknologjike. Takimet me asamblesit komunal, përfaqësues të komunës (drejtoratit të arsimit dhe drejtorateve të tjera relevante për nismën si urbanizmi, shërbimet publike etj.), gjithashtu shërbejnë për të avokuar efektivisht çështjen para vendim-marrësve. Takimet me vendim-marrësit duhet të përgaditen

DORACAK PËR NJË EKO SHKOLLË

paraprakisht, të strukturohen rreth axhendës së ngushtë të temës dhe të bazohen në informata sa më të sakta paraprake rreth kostos, natyrës, kohëzgjatjes, dhe ndikimit të intervenimit të nevojshëm. Informatat e hollësishme ndihmojnë vendim-marrësit të konsiderojnë me seriozitet çështjen e ngritur dhe ndikimin pozitiv të zgjidhjes së propozuar tek komuniteti. Takime të tilla mund të jenë më efektive në periudha parazgjedhore dhe në rastet kur investimet e nevojshme nuk janë të larta.

Vijimi i takimeve / dëgjimeve publike në komunë dhe avokimi për prioritetet e shkollës dhe komunitetit është një tjetër mekanizëm që duhet shfrytëzuar për të avokuar për ndryshimet e dëshiruara. Në këto takime është mirë që përveç drejtorit të shkollës të jenë prezentë edhe anëtarë të komunitetit dhe Këshillit Drejtues të Shkollës, apo të paktë personat e përfshirë në çështje.

Takimet me institucione qendrore dhe rajonale, gjithashtu mund të kërkohet në nisma të veçanta, sidomos në rastet kur nevojitet përkrahje/veprim institucional (p.sh. infrastruktura e kompanive rajonale publike, apo institucioneve qendrore si p.sh. Agjencia e Pyjeve, rregullatorët e ndryshëm, apo ministritë përkatëse, etj.). Ngjashëm me takimet me vendim-marrësit lokal, edhe takimet e nivelit qendror, duhet të përgaditen paraprakisht, të strukturohen rreth axhendës së ngushtë të temës dhe të bazohen në informata sa më të sakta paraprake rreth kostos, natyrës, kohëzgjatjes, dhe ndikimit të nismës. Parashtrimi i kërkesës specifike për veprim drejt institucionit përkatës duhet të jetë qëllimi kryesor i takimit.

Korrespondenca e shkruar mundëson dokumentimin e proceseve, transparencë, dhe korrektësi. Ajo gjithashtu forcon pozicionin e avokuesit përmes demonstrimit të konsistencës, dhe akumulimit të kërkesave dhe shkresave gjatë gjithë kohës. Korrespondenca e shkruar duhet të pasojë çdo takim sy më sy në formë të procesverballi të takimit, në mënyrë që të provojë/kërkojë veprime shtesë nëse është e nevojshme.

Ndërmarrja e veprimeve simbolike dhe inkuadrimi i nxënësve në përhapjen e vetëdijes ambientale është jetike për avokim të suksesshëm. Qoftë përmes dhënies së shembujve të mirë të veprimit ambiental në komunitet, apo përmes demonstrimeve/protestave simbolike për të vënë në pah shqetësime / probleme ambientale.